



OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

## 2. Inside System Touch shpk Nipt L92318009L

Vlera 6,674,000 (gjashte milion e gjashtëqind shtatëdhjetë e kater mije) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

## 3. INSTANT.AL shpk Nipt L81506043D

Vlera 6,432,000 (gjashte milion e katerqind e tridhjetë e dy mije) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

## 4. KALLFA shpk Nipt J71406006Q

Vlera 6,432,000 (gjashte milion e katërqind e tridhjetë e dymijë ) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

## 5. PC STORE shpk Nipt L01606034A

Vlera 6,432,400 (gjashte milion e katerqind e tridhjetë e dymijë e katerqind) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**Infosoft Office**” shpk u skualifikua duke qenë se nuk i plotësonte të gjitha kriteret si me poshte:

Referuar pikes 2.3.2.2 të kërkesave të vecanta të kualifikimit operatorët ekonomikë për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet , ndër të tjera, operatori ekonomik duhet te disponoje te pakten 2 specilaist te certifikuar për pajisjet objekt kontrate.

Certifikatat e trajnimit për specialistet duhet të jene të lëshuara nga prodhuesi i markës ose certifikata trajnimi ekuivalente nga distributor të autorizuar, shkolla profesionale të certifikuara, *akademi të autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt kontrate në pronësi të AK*. Në rast certifikatat e trajnimit duhet të shoqerohen me email -in e personit perkates të kontaktit për verifikimin e tyre.

Gjithashtu në shtojcën 6 “Specifikime teknike” të DST, janë listuar pajisjet që posedon Autoriteti Kontraktor, ndaj të cilave do të kryhen shërbimet periodike.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” ofertuesi PC Store shpk ka deklaruar ndër të tjera se ka dy punonjës E.M. dhe T.L. të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve nga XEROX. Ky fakt, vërtetohet edhe me dokumentat shoqoruese të ngarkuara në SPE.

Operatori ekonomik InfoSoft Office shpk nuk ka deklaruar se ka në stafin e tij punonjës të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve RICOH dhe nuk ka dokumenta shoqoruese të ngarkuara në SPE për të vërtetuar këtë kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

2. Operatori ekonomik “**Inside System Touch**” shpk u skualifikua duke qenë se nuk i plotësonte kriteret si më poshte:

Referuar pikës 2.3.2.2 të kërkesave të vecanta të kualifikimit operatorët ekonomikë për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet, ndër të tjera, operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 2 specilaist të certifikuar për pajisjet objekt kontrate. Certifikatat e trajnimit për specialistet duhet të jene të lëshuara nga prodhuesi i markës ose certifikata trajnimi ekuivalente nga distributor të autorizuar, shkolla profesionale të certifikuara, *akademi të autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt kontrate në pronësi të AK*. Në rast certifikatat e trajnimit duhet të shoqerohen me email -in e personit perkates të kontaktit për verifikimin e tyre.

Gjithashtu në shtojcën 6 “Specifikime teknike” të DST, janë listuar pajisjet që posedon Autoriteti Kontraktor, ndaj të cilave do të kryhen shërbimet periodike.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” ofertuesi Inside System Touch shpk nuk ka deklaruar se ka në stafin e tij punonjës të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve objekt i prokurimit, konkretisht RICOH dhe XEROX.

3. Operatori ekonomik “**INSTANT.AL**” shpk u skualifikua duke qenë se nuk i plotësonte kriteret si më poshte:

Referuar dokumentacioni të paraqitur nga operatori ekonomik, konstatohet se nuk është paraqitur asnjë dokument provues i kërkesave për kualifikim, si më poshtë:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2023, 2024 dhe 2025 lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e

---

përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 i ndryshuar "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.3.2.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

2. Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 2 specialiste të certifikuar për pajisjet objekt kontrate. Certifikatat e trajnimit për specialistet duhet të jenë të lëshuara nga prodhuesi i markës ose certifikata trajnimi ekuivalente nga distributori i autorizuar, shkolla profesionale të certifikuar, *akademi të autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt kontrate në pronësi të AK*. Në rast certifikatat e trajnimit duhet të shoqerohen me email -in e personit perkates të kontaktit për verifikimin e tyre.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose broshura për Softëare për menaxhimin e pajisjeve të printimit. Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të Softëare. (të perkthyer/të noterizuar)

2.3.4. Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001:2015 (Standard për sistemin e menaxhimit të cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.
2. ISO 14001:2015 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.
3. ISO 27001:2022(Standard për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit)/ekuivalente dhe e vlefshme.

4. Operatori ekonomik "**PC STORE**"shpk u skualifikua duke qenë se nuk i plotësonte kriteret si me poshte:

Referuar pikes 2.3.2.2 të kërkesave të vecanta të kualifikimit operatorët ekonomikë për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet , ndër të tjera, operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 2 specialiste të certifikuar për pajisjet objekt kontrate. Certifikatat e trajnimit për specialistet duhet të jenë të lëshuara nga prodhuesi i markës ose certifikata trajnimi ekuivalente nga distributori i autorizuar, shkolla profesionale të certifikuar, *akademi të autorizuar për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt kontrate në pronësi të AK*. Në rast certifikatat e trajnimit duhet të shoqerohen me email -in e personit perkates të kontaktit për verifikimin e tyre.

Gjithashtu në shtojcën 6 “Specifikime teknike” të DST, janë listuar pajisjet që posedon Autoriteti Kontraktor, ndaj të cilave do të kryhen shërbimet periodike.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” ofertuesi PC Store shpk ka deklaruar ndër të tjera se kanë tre punonjës A.B., R.SH. dhe E.M. të diplomuar Inxhinier Elektronikë dhe të certifikuar nga RICOH. Ky fakt, vërtetohet edhe me dokumentat shoqoruese të ngarkuara në SPE.

Operatoi ekonomik PC STORE shpk nuk ka deklaruar se ka në stafin e tij punonjës të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve XEROX dhe nuk ka dokumenta shoqoruese të ngarkuara në SPE për të vërtetuar këtë kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **KALLFA shpk me Nipt J71406006Q me adrese Tirane Njësia Bashkiake nr 5, Rr: Perlat Rexhepi, NDI, H13,16, Zip Code nr 1019 me vlerë 6,432,000 (gjashtë milion e katërqind e tridhjetë e dymijë ) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar